



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI
REKTORI

Nr. 886 Prot.

Tiranë, më 16.10.2023

URDHËR

Nr. 93, DATË 16/10/2023

MBI

**“FILLIMIN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË APLIKIMEVE DHE SHQYRTIMIT
TË DOKUMENTACIONIT, NGA ANA E FAKULTETEVE TË UART, PËR
STUDENTËT TË CILËT PËRFITOJNË PËRJASHTIM OSE REDUKTIM NGA
TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024, NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Bazuar në ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (i ndryshuar), në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”,

URDHËROJ:

1. Fillimin e pranimit të aplikimeve, nga ana e Fakulteteve të Universitetit të Arteve, për studentët të cilët përfitojnë përjashtim ose reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2023-2024.
2. Ngritjen e grupit të punës që do të merret me administrimin e procesit në çdo Fakultet. Personat përgjegjës sipas fakulteteve janë si më poshtë:
 - Nermin ZEBI (Fakulteti i Muzikës) – nermin_zebi@yahoo.com;
 - Arta DASHI (Fakulteti i Arteve të Bukura) – arta_dashi@yahoo.com;
 - Enela MASTORI (Fakulteti i Artit Skenik) – enelamastori@yahoo.com
3. Studentët duhet të dorëzojnë formularin e aplikimit si dhe gjithë dokumentacionin provues fizikisht dhe në adresën elektronike të personave të përcaktuar në pikën 2.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

4. Grupi i punës ka për detyrë të shqyrtojë dokumentacionin sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, i ndryshuar dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, (formulari bashkëngjitur), publikuar në faqen WEB të UART.
5. Personat përgjegjës, i regjistrojnë aplikimet e studentëve në një regjistër të veçantë dhe pasi shqyrtojnë dokumentacionin e paraqitur nga studentët, përcaktojnë studentët që përfitojnë përjashtim ose reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2023-2024.
6. Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit nga studentët është data 16.11.2023.
7. Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit në zyrën e protokollit në Rektorat nga grupi i punës është data 23.11.2023.
8. Në vijim të procedurës, dokumentacioni i kalohet Sektorit Juridik për verifikim.
9. Pas verifikimit të dokumentacionit të Grupit të Punës nga Sektori Juridik, përgatitet informacioni për Administratoren e Universitetit të Arteve.
10. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare WEB të Universitetit të Arteve dhe të afishohet në ambientet e Fakulteteve të UART.
11. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Dekanët, zyra e Protokollit të UART, personat përgjegjës në çdo Fakultet dhe sekretaritë e fakulteteve e sektori i IT për njoftimin dhe shpalljen e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Kastriot CAUSHI



**REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE**